

UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

- April 30** | **New Members Day**, by KDWW
May 2 | **N4CEB Meeting**, by KDWW and GIZ
May 14-15 | **E-Lösungstage**, in Düsseldorf
May 16 | **Roundtable Discussion on "Improving the Business Climate: Implementation of recommended reforms"** by the German Economic Team (GET), Pristina

SAVE THE DATES:

- October 1** | **SUBEX**, by KDWW and AHK Skopje, in Pristina
October 2-3 | **2nd German-Kosovar Economic Forum**, by KDWW in Pristina

[Fairs in Germany](#)

Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare,

Në këtë edicion të Newsletter, ju sjellim përmbledhjen më të fundit të lajmeve të aktiviteteve tona si dhe partnerëve; nga vizita në kompaninë MUNDA Kosova, Paneli i diskutimit "Njeriu, Teknologjia dhe Ekonomia e Re: Formësimi i së ardhmes së bashku" nga ESNAF Prizren, raporti i realizuar nga Lëvizja FOL në bashkëpunim me USAID, ceremonia e tretë kombëtare e ndarjes së granteve nga Regional Challenge Fund (RCF), vlerësimi i parë kreditor i Kosovës, lansimi i Këshillit Sektorial për Fuqinë Punëtore të Energjisë e deri tek konferenca vjetore për shënimin e Ditëve të Pronësisë Intelektuale dhe Ditës Botërore të Inovacionit dhe Kreativitetit.

Ju falenderojmë që jeni pjesë e komunitetit tonë!

Dear members of the German-Kosovar Business Association,

In this edition of our Newsletter, we bring to you the latest summary of news from our activities and our partners; from visiting the company MUNDA Kosova, the Panel Discussion "Human, Technology and the New Economy: Shaping the Future Together" from ESNAF Prizren, the report by Lëvizja FOL and USAID, the third national grant award ceremony in Kosovo by the Regional Challenge Fund (RCF), Kosovo's first credit rating, the launch of the Energy Workforce Council and the annual conference marking the Intellectual Property Days and World Creativity and Innovation Day.

We thank you for being a part of our community!

Ambasada Gjermane në Kosovë dhe OEGJK vizituan investitorin gjerman MUNDA Kosova

Ambasadori gjerman, Jörn Rohde, Zv. Ambasadori, Matthias Conrad, dhe Nora Hasani, Drejtoreshë Ekzekutive e OEGJK, vizituan investitorin gjerman, MUNDA Kosova.

Kjo Joint Venture, e specializuar në furnizimin e pjesëve të makinave premium gjermane, tashmë ka filluar fazën e paraprodhimit, ndërsa prodhimi në shkallë të plotë është i planifikuar të fillojë këtë vjeshtë.

German Embassy in Kosovo and KDWW visited german investor MUNDA Kosova

The German Ambassador, Jörn Rohde, the Deputy Ambassador, Matthias Conrad, and Nora Hasani, Executive Director of KDWW, visited MUNDA Kosova, a German manufacturing company.

This joint venture, specializing in supplying premium German car brands, has already started its pre-production phase, with full-scale manufacturing scheduled to begin this autumn.

Që nga viti 2021, OEGJK ka mbështetur në mënyrë aktive kompaninë MUNDA Kosova. Pjesëmarrja e tyre në Forumin Ekonomik Gjermano-Kosovar 2022 luajti një rol të rëndësishëm në vendimmarrjen e tyre për të investuar në Kosovë. Investimi i MUNDA dëshmon potencialin e madh të Kosovës.

MUNDA Kosova përfaqëson vlera thelbësore si përfshirja, barazia gjinore dhe diversiteti. Ne krenohemi me angazhimin e tyre për rikthimin e kuadrove në Kosovë, pasi ata kanë trajnuar tre inxhinierë përmes Programit të Bursave Zoran Djindjic në selinë e tyre në Gjermani dhe i kanë punësuar në Kosovë.

Since 2021, KDWV has actively supported MUNDA. Their participation in the German-Kosovar Economic Forum 2022 played a crucial role in their decision to invest in Kosovo. MUNDA's investment highlights the great potential of Kosovo.

MUNDA Kosova embodies core values like inclusion, gender equality, and diversity. We take pride in their commitment to brain gain, as they have trained three engineers through the Zoran Djindjic Scholarship Program at their headquarters in Germany and employed them in Kosovo.



Shoqata ESNAF organizoi panelin e diskutimit: "Njeriu, Teknologjia dhe Ekonomia e Re: Formësimi i së ardhmes së bashku"

Me rastin e 30-vjetorit të themelimit të Shoqatës ESNAF, u mbajt paneli "Njeriu, Teknologjia dhe Ekonomia e Re: Formësimi i së ardhmes së Bashku".

Pjesë e diskutimit ishin Nora Hasani, Drejtoreshë Ekzekutive e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, Driton Hapçiu, bashkëthemelues i Recura & Cactus, si dhe Ardian Hoxha, ndërmarrës dhe folës motivues.

ESNAF Association organized the panel discussion: "Human, Technology and the New Economy: Shaping the Future Together"

On the 30th anniversary of the establishment of the ESNAF Association, the panel "Human, Technology and New Economy: Shaping the Future Together" was held.

Part of the discussion were Nora Hasani, Executive Director of the German-Kosovar Business Association, Driton Hapçiu, Co-founder of Recura & Cactus and Ardian Hoxha, Entrepreneur and Motivational Speaker.

Në panel u diskutua mbi inovacionet më të fundit teknologjike, trendet ekonomike, rolin e grave në biznes dhe ndikimin e tyre në jetën sociale, duke adresuar edhe çështje të rëndësishme për komunitetin e biznesit

The topics of focus were the latest technological innovations, economic trends, the role of women in business, and their impact on social life, while also addressing important issues for the business community.



Regional Challenge Fund (RCF) mban ceremoninë e tretë kombëtare të ndarjes së granteve

Më 24 prill, RCF mbajti ceremoninë e tretë kombëtare të ndarjes së granteve në Kosovë.

Me qëllim të rritjes së konkurrencës së qëndrueshme të bizneseve në rajonin e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) deri sa ato progresojnë drejt tregut të vetëm të BE-së, RCF ofron grante për ofruesit e Arsimit dhe Aftësimit Profesional, për të adresuar nevojat për aftësim, në bashkëpunim të ngushtë me kompanitë.

Nga Kosova janë përzgjedhur 5 projekte, duke dëshmuar përkushtimin e vendit për avancimin e arsimit dhe aftësimin profesional në bashkëpunim me bizneset vendore.

Ndër projektet fituese bën pjesë edhe kompania anëtare e OEGJK, UBT Higher Education.

The Regional Challenge Fund (RCF) holds its third national grant Award Ceremony

On April 24th, RCF held the third national grant award ceremony in Kosovo.

With the aim of enhancing the sustainable competitiveness of businesses in the Western Balkans Six (WB6) region as they progress towards the EU single market, RCF offers grants to Vocational Education and Training (VET) providers, to address skill needs in close collaboration with companies.

5 projects from Kosovo are qualified, underscoring the country's dedication to advancing vocational education and training in collaboration with local businesses.

Among the winning projects is also KDWV's member, UBT Higher Education.

Kosova merr vlerësimin e parë kreditor

Agjencia ndërkombëtare, Fitch Ratings, ka dhënë vlerësimin e kredisë 'BB-' për Kosovën.

Vlerësimi i kredisë merr në konsideratë faktorët ekonomikë, financiar dhe politik, si rrjedhojë vlerësimi konkludon nëse shteti ka stabilitet ekonomik dhe financiar.

OEGJK u takua me përfaqësues të ekipit analitik të Fitch Ratings në shkurt të këtij viti dhe pati mundësinë të jepte kontributin e saj në vlerësimin e realizuar nga agjencia.

Vlerësimin mund ta gjeni në link-un në vazhdim:
[Fitch assigns Kosovo BB-](#)

Kosovo receives its first credit rating

The international agency, Fitch Ratings, has given the credit rating 'BB-' to Kosovo.

The credit assessment considers economic, financial and political factors, and the rating concludes as to whether the state has economic and financial stability.

KDWV met with representatives of the Fitch Ratings analytical team in February this year and had the chance to give its input in the assessment realized by the agency.

The rating can be found under this link: [Fitch assigns Kosovo BB-](#)

Lëvizja FOL publikoi Raportin mbi sinjalizimin në sektorin privat

Lëvizja Fol ka mbajtur një tryezë diskutimi me 17 prill, për të prezantuar dhe diskutuar raportin “Gjetjet e anketës mbi të kuptuarit dhe perceptimin e sinjalizimit nga punonjësit e sektorit privat”.

Qëllimi i raportit ishte vlerësimi i nivelit të informimit dhe perceptimi i sektorit privat për mekanizmin e sinjalizimit, dhe zbatimi i këtij mekanizmi në praktikë.

Raporti është i qasshëm për publikun dhe mund ta gjeni në link-un në vijim:
[51-Whistleblowing-Survey-ALB03.pdf \(levizjafol.org\)](#)

Lëvizja FOL published the Report on whistleblowing in the private sector

Lëvizja FOL held a roundtable discussion on April 17th, to present and discuss the “Survey findings on understanding and perception of whistleblowing by private sector employees”.

The purpose of the report was to assess the level of information and perception of private sector subjects about the signaling mechanism, and the implementation of this mechanism in practice.

The report is available to the public and can be found under the following link:
[51-Whistleblowing-Survey-ALB03.pdf \(levizjafol.org\)](#)

U lansua themelimi i Këshillit Sektorial për Fuqinë Punëtore të Energjisë

Me 25 Prill, u lansua themelimi i Këshillit Sektorial për Fuqinë Punëtore të Energjisë, i organizuar nga Aktiviteti për Zhvillimin e Fuqisë Punëtore përmes Sektorit Privat, i cili është një aktivitet 5-vjeçar i financuar nga USAID.

Këshilli ka për qëllim të mbështes sektorin privat në ofrimin e zgjidhjeve për fuqinë punëtore në Kosovë.

The Energy Sector Workforce Council was launched

On April 25th, the Energy Workforce Council was launched, organized by the Activity for the Workforce Development by the Private Sector, which is a 5-year USAID funded Activity.

The Council aims to support the private sector in offering solutions for the workforce development in Kosovo.

U mbajt konferenca vjetore për shënimin e Ditëve të Pronësisë Intelektuale dhe Ditës Botërore të Inovacionit dhe Kreativitetit

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit organizuan konferencën vjetore për shënimin e Ditëve të Pronësisë Intelektuale dhe Ditës Botërore të Inovacionit dhe Kreativitetit, e cila u mbajt sot.

Konferenca synon promovimin dhe informimin e shoqërisë mbi rëndësinë e pronësisë intelektuale, inovacionit dhe kreativitetit në zhvillimin e ekonomisë dhe shoqërisë. Në përputhje me këtë qëllim, konferenca u hap me moton “Rëndësia e inovacionit dhe krijimtarisë në ndërtimin e së ardhmes tonë të përbashkët”.

The annual conference to mark the Intellectual Property Days and World Creativity and Innovation Day was held

The Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade, and the Ministry of Culture, Youth and Sports, organized the annual conference to mark the Intellectual Property Days and World Creativity and Innovation Day, which was held today.

The Conference aims to promote and inform society on the importance of intellectual property, innovation and creativity in the development of the economy and society. In line with this purpose, the conference was opened under the theme “The importance of innovation and creativity in building our common future”.

U mbajt Konferenca për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

Në konferencën e sotme të organizuar nga International Labour Organization (ILO) me rastin e shënimit të Ditës Botërore për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, janë adresuar sfidat që hasen vazhdimisht në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Objektivat e konferencës përfshijnë theksimin e sfidave, ndarjen e praktikave më të mira, rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e bashkëpunimit për përmirësimin e standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

The Conference on Safety and Health at Work was held

At today's conference organized by the International Labour Organization (ILO) to mark World Day for Safety and Health at Work, challenges encountered in the field of occupational safety and health were addressed.

The objectives of the conference include highlighting challenges, sharing best practices, increasing awareness, and promoting collaboration to improve standards of safety and health at work.

YOUR CONTACT PERSONS AT KDWV

BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWV-OEGJK:

ICON Tower, 9th Floor, "Bekim Fehmiu" Str., no. 110; 10000 Prishtina

Monday – Friday | 8.30 – 16.30




Greta Kazia

HR, Përgjegjëse për Financa dhe Anëtarësi

HR, Responsible for Finance and Membership

greta.kazia@oegjk.org



Elena Elshani

Asistente Ekzekutive

Përfaqësuese për Shërbimin e Ekspertëve Seniorë (SES)

Executive Assistant

Senior Expert Service Representative (SES)

elena.elshani@oegjk.org



Besarta Hyseni

Udhëheqëse e Departamentit mbështetje dhe shërbime të anëtarëve

Këshilltare për Arsim Profesional Dual

Head of Market Entry & Events

Advisor for VET

besarta.hyseni@oegjk.org



Eriola Muhaxhiri

Udhëheqëse e Departamentit për Avokim dhe Marrëdhënie Qeveritare

Head of Department for Advocacy and Government Relations

eriola.muhaxhiri@oegjk.org




Jeta Sylja

Asistente Projekti

Project Assistant

Department for Market Entry & Events

jeta.sylja@oegjk.org



Rreze Gashi

Koordinatorë

Coordinator

Department for Advocacy and Government Relations

rreze.gashi@oegjk.org